



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. ____ Prot.,

Tiranë, më ____2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data: 10.02.2021]

Për: **“VILNIK MOTORS” SHPK**

Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesë 2 katëshe, Kati 2 , Km 6, Vaqarr, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim” - Shërbim - Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: “Riparim, mirëmbajtje automjesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës”, me fond të marrëveshjes kuadër: 3,339,200 (tre milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind) Lekë (pa TVSH) dhe me nr. REF-84113-01-15-2021.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Riparim, mirëmbajtje automjesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës”, me fond të marrëveshjes kuadër: 3,339,200 (tre milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind) Lekë (pa TVSH) dhe me nr. REF-84113-01-15-2021 dhe me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 24 (njëzet e katër) muaj të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.**

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 25.01.2021, Nr.11.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1) **“KADIU” SHA** **J61817045K**
Emri i plotë i shoqërisë **numri i NIPT-it**
Vlera: **3,339,164** (tre milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)
- 2) **“Xhadi Taci” PF** **L57702202U**
Emri i plotë i shoqërisë **numri i NIPT-it**
Vlera: **3,329,700** (tre milion e treqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)
- 3) **“VILNIK MOTORS” SHPK** **L01314031G**
Emri i plotë i shoqërisë **numri i NIPT-it**
Vlera: **3,080,600** (tre milion e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- | | |
|--|---|
| 1) “KADIU” SHA
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | J61817045K
<i>numri i NIPT-it</i> |
| 2) “Xhadi Taci” PF
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | L57702202U
<i>numri i NIPT-it</i> |

1. Arsyeja e skualifikimit për “KADIU” SHA

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.2 “Per kapacitetin Ekonomik dhe Financiar” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi bilanci i vitit 2019 nuk është i shoqëruar me Akt Ekspertizën (Raport auditimi) nga Ekspert Kontabël i Autorizuar, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”. Kjo, pasi Ofertuesi është në kushtet e përcaktimeve të gërmes “c” të dispozitës së mësipërme ligjore, dhe shoqërimi i bilancit të vitit 2019 me akt ekspertizën përkatëse nga ekspert kontabël i autorizuar, përbën detyrim ligjor.

2. Arsyeja e skualifikimit për “Xhadi Taci” PF

- Nuk përmbush pikën 2 të seksionit 2.1 “Për kapacitetin ligjor” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në ditën e hapjes së ofertave nuk arriti të paraqesë Certifikatë që vërteton cilesinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001.
- Nuk përmbush pikën 2 të seksionit 2.2 “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në ditën e hapjes së ofertave nuk arriti të paraqesë kopje të certifikuara të balanceve të viteve 2017, 2018 dhe 2019 të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore.
- Nuk përmbush pikën 2 të seksionit 2.3 “Për kapacitetin teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në ditën e hapjes së ofertave nuk arriti të provojë se ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, me profilet e punës të kërkuara në DST (motorrist, xhenerik, elektroaut) sipas kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”.
- Nuk përmbush pikën 5 të seksionit 2.3 “Për kapacitetin teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në ditën e hapjes së ofertave nuk arriti të provojë, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në DST, se disponon të gjitha pajisjet dhe instrumentet minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës.
- Nuk përmbush pikën 6 gërma e), seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë Certifikatë për transport mallrash në emër të tij. Në rastin konkret, operatori ekonomik “Xhadi Taci” PF ka marrë me qira automjetin karrotrec me targë AA945IY nga “Autoservis Babqarri”. Nga dokumentacioni i dorëzuar, vërtetohet se certifikata për transport mallrash e automjetit karrotrec me targë AA945IY të cilën e disponon Autoservis Babqarri, është specifike dhe e lëshuar për kryerjen e transportit të mallrave, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e operatorit ekonomik “Xhadi Taci” PF me automjetin e “Autoservis Babqarri” do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave

me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

- Nuk përmbush pikën 7, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të provojë që pjesët e këmbimit për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rastin konkret, ofertuesi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi në gjuhën shqipe në kundërshtim me pikën 4.6 seksioni 4 “Njoftimi i kontratës” të DST si dhe asnjë dokument tjetër, i cili të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe ofertuesit “Xhadi Taci” PF.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomik të suksesshëm:

1) “VILNIK MOTORS” SHPK

L01314031G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 3,080,600 (tre milion e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind) Lekë (pa TVSH)

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.01.2021;

Ankesa: Jo

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM